



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 10 mars 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U përcaktua çmimi i shitjes së energjisë elektrike nga Furnizuesi i Mundësisë së Fundit për muajin shkurt 2026 për klientët e lidhur në nivelin e tensionit 35 kV.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “GSA” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e tregimit të energjisë elektrike.

U vendos fillimi i procedurës për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Sunny Side Energy” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Intesa SanPaolo Bank Albania” sh.a.

U miratua dhënia e autorizimit për shoqërinë “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k. për transferimin (nëpërmjet vendosjes së barrës sigurorese) të aseteve të paluajtshme të saj, si mjet për garantimin e përmbushjes së detyrimit ndaj “Raiffeisen Bank” sh.a.

U vendos mosmarrja në shqyrtim e kërkesës së shoqërisë “EB ENERGY” sh.p.k. për marrjen e autorizimit të ERE-s për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj “ProCredit Bank” sh.a., për sa kohë marrëdhënia juridike me bankën është krijuar përpara se shoqëria të merrte statusin e të licencuarit dhe të lindnin detyrimet përkatëse në kuadër të këtij statusi.

Në kuadër të çështjeve të tjera, u shqyrtua informacioni në lidhje me bërjen efektive në (QKB) të vendosjes së kuotave si kolateral për garantimin e detyrimeve ndaj palëve të treta, në vijim të marrjes së autorizimit nga ERE për të licencuarit “NOVA SOLAR SYSTEM” sh.p.k., “GREEN PLUS ENERGY” sh.p.k., si dhe për ndryshimin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “RENEW” sh.p.k.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.